

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7130
E premte, 1 mars 2024
Çmimi 0.50 €

Hovenieri: Duhet të bisedohet për mënyrën e zbatimit të rregulores së BQK-së | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË TIRANË ËSHTË MBAJTUR SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR ME BE-në
MBI PLANIN E RI TË RRRITJES | FAQE 4-5

BE-ja NDAN 6 MILIARDË EURO PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, VEÇSE ME KUSHTE



Gjashtë miliardë euro. Ky është fondi që Bashkimi Evropian ka planifikuar të ndajë për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën

dhe Serbinë për periudhën 2024-2027, për ta përsheptuar integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Unifikimi i qëndrimeve të Ballkanit Perëndimor është i rëndësishëm,

por përfitimi 6 miliardë euro nga Bashkimi Evropian do të ndodhë vetëm nëse të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor do të avancojnë me reformat

KURTI NUK MERR PJESË NË SAMITIN E BALLKANIT PERËNDIMOR ME BE-NË NË TIRANË, OPOZITA E KRITIKON: KRYEMINISTËR, KU JE? | F. 7



IKD-ja THOTË SE MURATI S'PO VEPRON PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT TË PENSIONISTËVE, E LAJMËRON PËR PASOJAT | F. 6



AKTUALE



NUMRI I VIKTIMAVE NË GAZË E KALON SHIFRËN PREJ 30 000, SIPAS ZYRTARËVE SHËNDETËSORË | F. 2

FREEDOM HOUSE: KOSOVA DHE SHQIPËRIA, VENDE PJESËRISHT TË LIRA | F. 7

BE-ja: RAPORTI I ODHIR-it KONFIRMON SHQETËSIMET PËR PARREGULLSI NË ZGJEDHJET NË SERBI | F. 6

EKONOMI



"ELEKTROSEVER"-I NJOFTON SE KA NISUR FATURIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË VERI | F. 8

ISMAILI: BQK-ja PO NDËRMERR VEPRIME PËR T'I PLOTËSUAR KRITERET PËR ANËTARËSIM NË SEPA | F. 8

SPORT



GRUPI KOORDINUES DISKUTON PËR PLANIN PESËVJEÇAR TË INFRASTRUKTURËS SË FUTBOLLIT | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hovenieri: Duhet të bisedohet për mënyrën e zbatimit të rregullores së BQK-së

PRISHTINË, 29 SHKURT - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të enjten se duhet të bisedohet për mënyrën e zbatimit të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), që e përcakton euron si valutë e vetme për kryerjen e pagesave me para të gatshme. Hovenieri i ka bërë këto deklarata gjatë një bashkëbisedimi me gazetarë në ndërtesën e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Ai ka thënë se dialogu mund të mos jetë vendi më i përshtatshëm për të diskutuar për çështjet e brendshme të Kosovës, por që tema e dinarit duhet të negociohet, pasi Kosova ka dhënë zotim për t'i mbrojtur komunitetet pakicë. Hovenieri ka insistuar se Shtetet e Bashkuara nuk janë duke e sfiduar përgjegjësinë

dhe autoritetin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe as nuk po e mbrojnë dinarin, por janë të shqetësuara për mënyrën e zbatimit të rregullores së BQK-së. "Ka ndikim të drejtpërdrejtë tek individët që janë më të cenueshëm", ka thënë Hovenieri, duke e marrë shembullin e ndonjë të moshuari 70-vjeçar që është mësuar të shkojë në një zyrë për ta marrë pensionin, raporton REL.

Mes të tjerash, Hovenieri ka thënë se Serbia nuk duhet të ketë veto për mënyrën e ofrimit të ndihmës, por duhet të diskutohet kjo çështje. Rregullorja e re e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt të këtij viti, e përcakton euron si valutë e vetme për kryerje të pagesave me para të gatshme



në Kosovë. Kjo rregullore i ka prekur komunitatet me shumicë serbe në Kosovë, pasi në to përdoret edhe dinari serb. Shteti i Serbisë deklaroi se ndan miliona euro për serbët në Kosovë dhe ua paguan atyre rrogat, pensionet dhe ndihmat shtesë.

Shtetet e Bashkuara i kanë bërë

thirrje të vazhdueshme Kosovës ta pezullojë vendimin për dinarin serb dhe që bisedimet për rregulloren e BQK-së në Bruksel "të vazhdojnë urgjentisht".

Më 27 shkurt delegacioni i Kosovës dhe i Serbisë janë takuar në Bruksel, nën ndërmjetësim të Bashkimit

Evropian për këtë çështje, por zyrtarët evropianë kanë thënë se "takimet shtesë do të jenë të nevojshme".

Kushtetuta e Kosovës përcakton që duhet të ekzistojë vetëm një valutë për kryerje të pagesave me para të gatshme. Kosova nuk është pjesë e Eurozonës - të cilën e përbëjnë 20 vende anëtare të Bashkimit Evropian - por e ka euron si valutë kryesore prej vitit 2002. Disa serbë në Kosovë kanë treguar se nuk po mund të marrin të ardhurat prej Serbisë në dinarë në mungesë të kësaj valute.

Dogana e Kosovës e ka ndaluar dy herë këtë vit hyrjen e dinarëve në Kosovë, me arsyetimin se diçka e tillë nuk është autorizuar prej BQK-së, institucionit të vetëm që mund ta bëjë importimin dhe eksportimin e valutave.

Numri i viktimave në Gazë e kalon shifrën prej 30 000, sipas zyrtarëve shëndetësorë

GAZA, 29 SHKURT - Më shumë se 30 000 palestinezë janë vrarë në Rripin e Gazës prej fillimit të luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit të shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe BE-ja - që nisi para pesë muajve, thanë zyrtarët shëndetësorë në këtë territor.

Rritja e numrit të viktimave erdhi pasi, sipas dëshmitarëve, trupat izraelite shtinë mbi një turmë të njerëzve që po prisnin për të marrë ndihmë humanitare në Gaza City, duke i vrarë qindra dhe plagosur shumë të tjerë, raporton Associated Press.

Së paku 104 njerëz u vranë në turmën ku palestinezët u



rreshtuan për të marrë ndihmë, tha zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, Ashra fal-Qidra. Rreth 760 u plagosën, tha

ai. Kjo luftë i ka detyruar 80 për qind të popullsisë së Gazës prej 2.3 milionë banorësh të ikin nga

shtëpitë e tyre, ndërsa zyrtarët e OKB-së thonë se një çerek i popullsisë po vuan urie.

Ministria e Shëndetësisë e Gazës - e cila tha të enjten se numri i përgjithshëm i palestinezëve të vdekur nga kjo luftë në këtë territor ka arritur në 30 035, ndërsa 70 457 të tjerë janë plagosur - nuk bën dallim mes luftëtarëve dhe joluftëtarëve në llogaritjet e saj.

Izraeli thotë se i ka vrarë 10 000 pjesëtarë të Hamasit, pa dhënë ndonjë dëshmi.

Ofensiva ajrore, detare dhe tokësore e Izraelit, e nisur si përgjigje ndaj sulmit të Hamasit më 7 tetor në Izrael, ka shkaktuar rrënim të madh në Gaza City,

duke e izoluar atë nga pjesa tjetër e territorit tash e shumë muaj, duke bërë që shumë pak ndihma të futen brenda saj.

Lufta e ka shkaktuar një katastrofë të madhe humanitare në Gazë dhe ka nxitur shqetësime globale për situatën në Rafah, qytetin jugor të Gazës përgjatë kufirit me Egjiptin, ku 1.4 milion palestinezë kanë kërkuar strehim nga bombardimet e përditshme izraelite.

Lufta nisi pasi pjesëtarët e Hamasit u futën vrullshëm në jug të Izraelit më 7 tetor, duke i vrarë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i rrëmbyer 250 pengje.

Parlamenti Evropian: Të hiqet vetoja në procesin e zgjerimit

BRUKSEL, 29 SHKURT - Parlamenti Evropian ka miratuar të enjten një rezolutë për procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE), përmes së cilës kërkoi që ky proces të bëhet më efikas, duke e hequr përdorimin e vetos për vendet anëtare. Rezoluta kërkon gjithashtu që BE-ja ta ketë një buxhet më efikas, në mënyrë që të jetë në gjendje ta përballojë zgjerimin me vende të reja anëtare. Rezoluta u mbështet nga 305 deputetë, ndërsa 157 deputetë votuan kundër dhe 71 abstenuan. Bashkimi Evropian,

aktualisht, për secilin vendim në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë, ku hyn edhe procesi i zgjerimit, duhet të gjejë konsensus. Kjo ka bërë që shpesh vendimet të bllokohen nga ndonjë shtet anëtar përmes vetos, edhe kur të gjitha të tjerat ishin në favor. Kjo është rezoluta e fundit për procesin e zgjerimit që miraton Parlamenti Evropian në këtë përbërje, pasi zgjedhjet e reja në bllok do të mbahen në qershor.

Ky institucion i BE-së e ka mbështetur fuqishëm procesin e zgjerimit, ndërkaq me këtë rezolutë kërkon që

BE-ja të reformohet para se të zgjerohet.

Parlamenti Evropian mbështet edhe integrimin gradual të vendeve kandidate në tregun unik të BE-së përgjatë procesit të zgjerimit, edhe para se ato të bëhen anëtare formale të bllokut. "BE-ja ka nevojë për një vizion afatgjatë politik dhe për reforma institucionale dhe financiare për të siguruar kapacitete për absorbimin e anëtarëve të ri", thuhet në tekstin e rezolutës të cilën e kanë miratuar deputetët e Parlamentit Evropian të enjten.



Eurodeputetët kërkojnë që përgatitjet për zgjerim të zhvillohen paralelisht edhe në Bashkimin Evropian dhe në vendet kandidate. Ata

kërkojnë edhe mbrojtje më të fuqishme të vlerave demokratike të Bashkimit Evropian dhe sundimit të ligjit.

IKD-ja thotë se Murati s'po vepron për zgjidhjen e problemit të pensionistëve, e lajmëron për pasojat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 SHKURT - Të premten e javës së kaluar, më 23 shkurt, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) i është drejtuar ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, me një kërkesë për kthimin e ligjshmërisë dhe zbatimin e drejtë të ligjit në raport me pensionistët e Kosovës, të cilët janë edhe përfitues sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre.

Kjo kërkesë ka ardhur si rezultat i analizës së bërë nga IKD-ja përkitazi me situatën e qytetarëve të vendit, pensionistëve, të cilëve përkundër punës disavjeçare dhe arritjes së moshës së pensionimit, është duke iu mohuar e drejta në pensionin bazik si rezultat i keqkuptimit dhe keqinterpretimit të ligjit nga ana e Departamenteve të Pensioneve të

MFPT-së.

Sipas ligjit dhe vendimeve të gjykatave të rregullta, përfshirë vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, vendime këto të formës së prerë, secilit qytetar të Republikës së Kosovës i njihet e drejta për pension bazik dhe për ata që kanë plotësuar kriteret për përfitimin e të drejtave dhe përfitimet e përcaktuara me Ligjin për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre, u takon të jenë përfitues edhe nga ky ligj.

Edhe përkundër këtij fakti, fatkeqësisht, Departamentet e Pensioneve në MFPT po ua mohojnë këtë të drejtë që ligji ua njeh të gjithë qytetarëve dhe që lidhur me këtë çështje është ndërtuar edhe praktika gjyqësore. Kjo po bëhet me arsyetimin se nuk u takon të marrin më shumë sesa një pension.

Lidhur me këtë situatë, IKD-ja e ka njoftuar ministrin Murati, se vetëm brenda dy muajve të fundit

IKD-ja, përmes Qendrës për Ndihmë Juridike falas, ka pranuar mbi 500 kërkesa nga qytetarët e Republikës së Kosovës, si nga komuniteti shqiptar, ashtu edhe nga komunitetet joshumicë, prej të cilave deri më tani janë përgatitur rreth 200 padi, të cilat, në bazë të praktikës gjyqësore dhe kornizës ligjore, nuk pritet të vendosen ndryshe, përveçse në favor të qytetarëve të vendit, bazuar kështu në legjislacionin pozitiv dhe vendimet e gjykatave të rregullta që e trajtojnë këtë fushë.

IKD, po ashtu, ka kërkuar që sa më shpejt të vepron në drejtim të adresimit të kësaj situatë, sepse qasja e MFPT-së përkitazi me këto raste ka krijuar një situatë të pakëndshme, ku me mijëra qytetarë të Kosovës, të moshave që arrijnë edhe 92-vjeçarë, po detyrohen të enden zyryve të Departamenteve të Pensioneve, po detyrohen të vijnë nga rajone të ndryshme, të thella të vendit, duke krijuar shpenzime të panevojshme, vetëm e vetëm për ta kërkuar realizmin e një të drejte

që u takon.

Përveç kësaj, IKD-ja e ka njoftuar ministrin Murati për pasojat e rasteve të iniciuara, ku për çdo padi të fituar në gjykatë, ministria, përveçse do të jetë e obliguar t'i kompensojë pensionistët për të drejtat e tyre për periudhën në vijim, do të obligohet të paguajë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive, shpenzimet procedurale lidhur me lëndët në fjalë, ku përfshihen avokatët për shërbimet e tyre, përfshirë këtu edhe shpenzimet gjyqësore. Ndërsa duhet ditur se për çdo rast duhet të hapet shqyrtim gjyqësor, të dërgohen ftesat për seanca gjyqësore, gjë që, krahas të tjerave, krijon edhe shpenzime të udhëtimit për pensionistët për të udhëtuar në Prishtinë nga çdo cep i Kosovës vetëm sa për të marrë pjesë në seancat gjyqësore në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Andaj, IKD-ja ka kërkuar nga ministri Murati t'i ushtrojë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij si ministër dhe pa vonesë ta

kthejë dhe zbatojë ligjshmërinë përmes nxjerrjes së një akti juridik, përmes të cilit obligon Departamentet e Pensioneve ta bëjnë zbatimin e duhur të ligjeve të Republikës së Kosovës, gjegjësisht ta shmangin interpretimin e gabuar që po i bëhet legjislacionit aktual. Kështu, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët e kanë arritur moshën e pensionimit dhe që, po ashtu, kanë plotësuar kriteret për përfitimin e beneficioneve nga Ligji për Kategoritë e Dala nga Lufta, t'i realizojnë të drejtat e tyre në dy skema pensionale njëkohësisht - atë të moshës, si dhe atë që rrjedh nga Ligji për statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, Viktimave civile dhe Familjarëve të tyre. Nxjerrja e aktit juridik do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e ligjit në mënyrë të drejtë dhe do ta ruante dhe respektonte dinjitetin e pensionistëve në Kosovë.



Një kontingjent i ri turk i KFOR-it arrin në Kosovë

PRISHTINË, 29 SHKURT - KFOR-i ka bërë me dije se ka arritur në Kosovë një kontingjent i

trupave turke. Në njoftimin për medie theksohet se ky kontingjent do të

zëvendësojë një njësi të trupave italiane të dislokuara më parë. KFOR-i në

"Facebook" ka publikuar fotografi nga zbakimi i tyre në Kosovë.





NË TIRANË ËSHTË MBAJTUR SAMITI I BALLKANIT PERËNDIMOR ME BE-në MBI PLANIN E RI TË RRTJES

BE-ja ndan 6 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor, veçse me kushte

Gjashtë miliardë euro. Ky është fondi që Bashkimi Evropian ka planifikuar të ndajë për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë për periudhën 2024-2027, për ta përshpejtuar integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Unifikimi i qëndrimeve të Ballkanit Perëndimor është i rëndësishëm, por përfitimi 6 miliardë euro nga Bashkimi Evropian do të ndodhë vetëm nëse të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor do të avancojnë me reformat

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

TIRANË, 29 SHKURT - Gjashtë miliardë euro. Ky është fondi që Bashkimi Evropian ka planifikuar të ndajë për Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë për periudhën 2024-2027, për ta përshpejtuar integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Plani, pak a shumë, thotë kështu: Kush i kryen reformat e parapara, i merr fondet. Ata që nuk punojnë, mbeten prapa. Për më shumë, asnjë vend nuk do të mund ta bllokojë tjetrin në këtë proces. Madje, nëse vërehen përpjekje, ato mund të ndëshkohen. Ndër synimet kryesore të të ashtuquajturit "Plan i Rritjes për Ballkanin Perëndimor" është që të forcohet një treg i përbashkët

rajonal, i integruar gradualisht me atë të BE-së. Komisionari për Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka thënë se në samitin rajonal në Tiranë për planin e Bashkimit Evropian për rritjen ekonomike në Ballkanin Perëndimor, ka pasur pajtim me liderët ballkanikë që këtë vit të ketë rezultate në katër fusha. Gjatë konferencës për medie pas samitit, Varhelyi tha se e para ka të bëjë me sistemin e pagesave në zonën euro (SEPA). Rishikimi i rregullave për të, komisionari tha se është i lehtë, pasi shumica e bankave që operojnë në rajon, janë banka evropiane. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përdori si shembull paratë që dërgon diaspora në vendet e origjinës. Ai tha se me tarifatat aktuale ata paguajnë gjashtë herë më shtrenjtë për transaksionet. Prandaj, sipas tij, ky sistem do të kursejë para të

qytetarëve. "Plani i ri do të lejojë që ta çojmë këtë kosto në nivelin e njëjtë të shteteve anëtare, që vetëm me këtë do të kursejmë gjysmë miliardë euro", ka thënë Rama. Fusha e dytë, e cila sipas planit të rritjes ekonomike - vlera e të cilit për periudhën 2024-2027 është 6 miliardë euro - ka të bëjë me krijimin e korsive të gjelbra. Kjo, sipas Varhelyit, nënkupton që të mos ketë pritje në pikat kufitare në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Fusha e tretë, që rajoni së bashku me BE-në pret të japë rezultate këtë vit, është puna kërkimore dhe shkencore që, sipas Varhelyit, nënkupton sjelljen e brezit të ri të industrive inovative në rajon. Dhe fusha e katërt, është që të gjitha komunat në rajon të kenë mundësi të ofrojnë rrjetet falas të internetit në hapësirat publike. "Po ashtu,

diskutuar se çfarë do të bëjmë vitin e ardhshëm", ka thënë ai, duke shtuar se pret ide nga vendet e rajonit në këtë drejtim. Gjatë konferencës me zyrtarin e lartë evropian, Rama ka thënë se, pavarësisht se aktualisht ka vullnet të mirë, ai tha se "mendësia" e shteteve të rajonit mund të paraqitet si pengesë në zbatimin e planit të rritjes. "Pengesa e vetme më e madhe që mund t'i trembemi është mendësia në mesin e shteteve të rajonit sepse, siç thashë më parë, ky plan i ri i rritjes se çfarë duhet të bëjmë në planin rajonal është i njëjtë për atë që kemi rënë dakord 10 vjet më parë kur nisëm Procesin e Berlinit", ka thënë Rama, duke shtuar se plani ka ngjashmëri me konceptin e nismës së Ballkanit të Hapur. Ai paralajmëroi kundër përfshirjes së çështjeve politike dypalëshe në integrimin rajonal dhe evropian. "Integrimi evropian shkon përmes integritit rajonal dhe plani i ri i rritjes e vulos këtë", ka thënë ai, duke shtuar se të gjitha "gjeputat e dëguara" për Ballkanin e Hapur - nismë rajonale e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, që është

kundërshtuar nga Kosova, tani janë ekspozuar si të tilla. Paraprakisht, gjatë samitit, Varhelyi ka thënë se plani i rritjes ishte ambicioz që mund ta mundësojë dyfishimin e gjashtë ekonomive ballkanike në dhjetë vjetet e ardhshëm. Por, ai tha se në mënyrë që plani të jetë funksional, shtetet e rajonit duhet t'i aplikojnë reformat dhe kriteret e kërkuara. Sipas Varhelyit, plani është pjesë e procesit të zgjerimit dhe nënkupton që, krahas reformave të bëra nga shtetet aspiruese të rajonit, blloku t'u ofrojë atyre "të gjitha përfitimet që sjellë anëtarësimi para se shtetet tuaja të bëhen anëtare të BE-së". "Jemi në fillimet e ndryshimit shumë të shpejtë në Ballkanin Perëndimor", ka theksuar ai. Ndërkaq, gjatë takimit kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se për planin e rritjes shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet të angazhohen pa asnjë rezervë. "Me planin e rritjes do të marrim hapat e nevojshëm për të ecur më pranë njëri-tjetrit dhe BE-së, ose do të rrezikojmë të dështojmë për të zënë një vend

Kurti nuk merr pjesë në Samitin e Ballkanit Perëndimor me BE-në në Tiranë, opozita kritikon: Kryeministër, ku je?

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 SHKURT - Në Tiranë është zhvilluar Samiti i përbashkët i Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian me fokus në planin e rritjes - iniciativës për investime konkrete të BE-së në shtetet e rajonit tonë. Por kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka reaguuar për mospjesëmarrjen e kryeministrit Albin Kurti në këtë samit.

Krasniqi ka shtuar një pyetje për Kurtin: Kryeministër, ku je? "Sot, në Tiranë po zhvillohet Samiti i përbashkët i Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor me fokus në Planin e Rritjes - iniciativës për investime konkrete

të BE-së në shtetet e rajonit tonë. Vlera e ndarë nga BE-ja për këtë plan për periudhën 2024-2027 është 6 miliardë euro, e ku mundësia që Kosova të përfitojë qindra-miliona euro investime, është tashmë e konfirmuar. Dhe pikërisht në këtë Samit, ndër më të rëndësishmit për shtetin tonë, kryeministri i Kosovës ka vendosur që të mos marrë pjesë. Në vend të tij, ai ka zgjedhur që javën ta kalojë në Irlandë të Veriut, duke mbajtur ligjërata boshe e pa ndikim nëpër shkolla", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Lideri i PDK-së ka thënë se kjo papërgjegjësi dhe ikje nga obligimet e tij parësore si kryeministër është e

pabesueshme. "Sot kryeministri i Kosovës vendin e ka pasur në Tiranë, në mesin e liderëve të tjerë të Ballkanit Perëndimor e të Bashkimit Evropian. Një gjë është e qartë: me këtë qasje të Kryeministrit Kurti, Kosova jo që nuk do të përfitojë investime të reja, mirëpo as sanksionet aktuale të vendosura nga BE ndaj shtetit tonë, nuk do të hiqen. Një kryeministër idhnak, i papërgjegjshëm e që vuan nga kompleksi i inferioritetit, fatkeqësisht për Kosovën, nuk do të arrijë të thellojë as raportet mbarë-shqiptare, e lëre më ato rajonale dhe evropiane. Kryeministër, kthjellu!", ka theksuar Krasniqi.

Edhe ish-kryeministri Avdullah

Hoti, aktualisht deputet i LDK-së, ka theksuar se nuk ka asnjë arsytim pse Kosova nuk është e pranishme në Tiranë në Samitin e Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Hoti ka shkruar në "Facebook" se nuk ka agjendë më të rëndësishme për qeverinë se ky samit, përveç ndonjë emergjence kombëtare. "Jam i sigurt se ligjëratat nëpër Irlandën Veriore janë vetëm pretekst për të ikur nga ky takim. Samiti në Tiranë është vendi për të prezantuar nevojat dhe projektet, si dhe për të bërë konsultimet e nevojshme me partnerë. Aty është vendi për të insistuar dhe avokuar për zhblokimin e 300 milionë eurove për projekte për shkak të masave

të BE-së ndaj Kosovës. Sipas Komisionierit për Zgjerim, Oliver Varhelyi, plani i BE-së për rritjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor është konceptuar në Tiranë. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës do të duhej të bënte konsultime të ngushta me Qeverinë Rama përpara këtij samiti", ka thënë Hoti.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, ka thënë për "Klan Kosovën" se për shkak të angazhimeve të mëparshme, kryeministri Kurti nuk do të jetë i pranishëm fizikisht në samitin e së enjtes në Tiranë. "Megjithatë kryeministri Kurti do të jetë pjesë e samitit virtualisht përmes një video-adresimi", ka thënë Kryeziu.



më pranë BE-së. Ose e bëjmë së bashku, ose dështojmë së bashku, ekonomitë tona nuk mund të lulëzojnë duke penguar lëvizjen e lirë të njera-tjetres. Ose bëjmë paqe për të punuar për begatinë tonë, ose mungesa e kësaj begatie do të na bëjë të humbasim paqe. Kështu funksionon BE-ja, kështu duhet të funksionojë Ballkani Perëndimor", ka thënë ai. Në samit, përveç Ramës, i cili

ishite nikoqir, morën pjesë edhe liderët e tjerë rajonalë: presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, dhe presidentja e Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Borjana Kristo. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, "për shkak të angazhimeve të mëparshme", nuk ishte i pranishëm fizikisht në samitin e 29 shkurtit. "Megjithatë, Kurti do

të jetë pjesë e samitit virtualisht përmes një video-adresimi", tha Kryeziu. Në samit përmes videolidhjes është paraqitur edhe kryeministri i Malit të Zi, Millojko Spajiq. Plani i BE-së për Ballkanin Perëndimor synon rritjen ekonomike të rajonit, përshtetimin e reformave të duhura, dhe kryerjen e investimeve që mund të avancojnë procesin e zgjerimit të

BE-së me këto vende. Ky samit u zhvillua me moton "më të mirë bashkë". Unifikimi i qëndrimeve të Ballkanit Perëndimor është i rëndësishëm, por përfitimi 6 miliardë euro nga Bashkimi Evropian do të ndodhë vetëm nëse të gjitha vendet në Ballkanin Perëndimor do të avancojnë me reformat. Një samit i ngjashëm për këtë plan u mbajt më 22 janar në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë këtij samiti u nënshkrua marrëveshja për shtëpinë e re të Kolegjit të Evropës që do të hapë dyert në Tiranë këtë vit akademik. Marrëveshja u nënshkrua nga ministrja e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, rektori i Universitetit të Tiranës, Artan Hoxha dhe rektorja e Kolegjit të Evropës, Federica Mogherini, në prani të kryeministrit Rama dhe komisionarit Varhelyi.

BE-ja: Raporti i ODHIR-it konfirmon shqetësimet për parregullsi në zgjedhjet në Serbi

PRISHTINË, 29 SHKURT - Bashkimi Evropian vlerëson se raporti përfundimtar i zyrës për demokraci, institucione dhe të drejta të njeriut së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për zgjedhjet në Serbi "konfirmon shqetësimet e BE-së" dhe kërkon që Serbia t'i adresojë raportet për parregullsi në zgjedhje në mënyrë transparente. Kështu tha përmes një postimi të bërë në emër të BE-së, zëdhënësi i këtij institucioni, Peter Stano.

Ky ishte reagimi i parë i BE-së pas publikimit të raportit të ODHIR-it, raporton Rel.

ODHIR-i ka monitoruar zgjedhjet e mbajtura në Serbi vitin e kaluar, ndërsa vëzhgues në ato zgjedhje ka pasur edhe nga Parlamenti Evropian.

Edhe deputetët e Parlamentit Evropian kishin raportuar një varg parregullsish në zgjedhjet parlamentare, lokale dhe krahinore dhe përmes një rezolute urgjente kishin kërkuar hetim



ndërkombëtar për parregullsitë. "Raporti final i ODHIR-it për zgjedhjet në Serbi konfirmon shqetësimet e BE-së: procesi zgjedhor ka nevojë për

përmirësime të dukshme dhe reformat e mëtejme. Raportet për parregullsi duhet të hetohen në mënyrë transparente, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me

zgjedhjet lokale", tha Stano. "BE-ja mirëpret shprehjen e gatishmërisë së autoriteteve në Serbi për të punuar në zbatimin e rekomandimeve. Nuk ka kohë për

të humbur në prag të zgjedhjeve të ardhshme në vend", shtoi ai.

Në raportin e ODIHR-it, të publikuar më 28 shkurt, u tha se në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të Serbisë "ka dominuar pjesëmarrja vendimtare e presidentit [të Serbisë, Aleksandar Vuçiq], që së bashku me përparësitë sistematike të partisë së pushtet [Partisë Progresive Serbe], ka krijuar kushte jo të barabarta për pjesëmarrësit në procesin zgjedhor".

Aty, po ashtu, u tha se në zgjedhjet e 17 dhjetorit në Serbi, mes të tjerash, liritë themelore në përgjithësi janë respektuar, por në fushatën zgjedhore ka pasur një retorikë të ashpër, anshmëri në raportimet e medieve në shtetërore dhe keqpërdorim të resurseve publike. Raporti konstaton, po ashtu, se nuk janë përdorur në mënyrë të mjaftueshme mekanizmat për parandalimin e frikësimit dhe presionit ndaj votuesve.

'Deputetët s'kanë mandat për t'i cenuar trupat tanë!'



PRISHTINË, 29 SHKURT - Kolektivi "Marshojmë s'festojmë" ka realizuar të enjten një aksion para Kuvendit të Kosovës pasi deputetët janë shprehur kundër Projektligjit për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor. Përfaqësues të Kolektivit

"Marshojmë s'festojmë" kanë mbajtur pankarta me mbishkrime si "Deputetët s'kanë mandat me i cenu trupat tanë", "Duda, ku i ki kufijtë", "Shteti laik, ku?", "Eman, mos rrej" etj. "Diskutimi i ditëve të fundit, brenda e jashtë Kuvendit mbi Projektligjin për Shëndetin

Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor ka qenë dehumanizues ndaj grave të Kosovës. I njëjti, është përcjell me propagandë edhe me gënjeshtër nga deputetët, për qëllime patriarkale e elektorale. Ne jemi këtu sot, për të demantuar këto gënjeshtër, dhe

për t'ua thënë me zë të lartë emrat deputetëve patriarkalë. Eman Rrahmani, Duda Balje, Albena Reshitaj, Visar Korenica e deputetë të tjerë, e gënjyen publikun duke thënë se ky ligj e shkatërron familjen dhe e mundëson incestin. Krejt kjo, përderisa në spitalet private në

Kosovë dhe jashtë Kosovës, janë duke u derdhur shuma të mëdha parash, për realizimin e fertilizimit të asistuar mjekësor nga gratë e çiftet që kanë nevojë për të. Deputetët tanë diskutojnë për skenare absurde, abstrakte dhe nacionaliste, përderisa grave e çifteve në Kosovë iu shteren xhepat në spitale private, të pambrojtur. Këta deputetë nuk i konsiderojnë gratë individë me aftësi për të marrë vendime për veten dhe të ardhmen e tyre riprodhuese. Për ta, gratë janë individë me fuqi vendimmarrëse për trupat e tyre, vetëm nëse janë të martuara me një burrë. Duke u thirrur në lirinë e fjalës e pozicionit personal, këta deputetë, që s'përfaqësojnë veten, por popullin, po shkelin mbi të drejtat e shëndetit riprodhues të grave dhe po i trajtojnë trupat tanë vetëm si makina riprodhimi që përdoren për politika nataliteti, duke shkelur përmby agjencinë tonë trupore, si gra', thuhet në mesazhin e përfaqësuesve të Kolektivit "Marshojmë S'festojmë", duke bërë thirrje që të votohet në Kuvend Projektligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor, duke mundësuar këtë procedurë për çiftet dhe gratë e beqare.

Vazhdon projekti për siguri në shkolla

Prishtinë, 29 shkurt - Të gjitha stacionet policore të rajonit të Prishtinës janë duke realizuar takime me përfaqësues të shkollave, prindër si dhe ligjërata për nxënësit nëpër

shkolla. Ligjëratat me nxënësit janë pjesë e projekteve informuese, parandaluese dhe edukuese që kanë rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe mbrojtjen e komunitetit nga

dukuritë asociale si dhe për ofrimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Bazuar në planifikimet në kuadër të stacioneve do të vazhdojnë ligjëratat rreth

delikucensës së të miturve, rregullave të trafikut, dhunës në familje, pasojat e përdorimit të narkotikëve, bullizmit dhe masave parandaluese, ngacmimeve seksuale etj.



UNDP-ja: Rreth 60 për qind e qytetarëve besojnë se marrëveshja e Ohrit do të ndikojë pozitivisht në jetën e tyre

PRISHTINË, 29 SHKURT - Një anketim i Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, i publikuar të mërkurën, vë në pah se rreth 60 për qind e qytetarëve në Kosovë besojnë se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të ndikojë pozitivisht në jetën e tyre. "Nëpërmjet dy përgjigjeve 'besoj plotësisht që do të ndikojë' dhe 'besoj që do të ndikojë' mbledhet një total prej 60.8-përqindësh, ndërsa ky numër ishte 58 për qind në prill të vitit 2023, kështu që shohim një rritje të lehtë pozitive në perceptimin e qytetarëve se si do të ndikohen nga kjo marrëveshje", ka thënë Alisa Hasani, menaxhere e projektit. Ajo ka theksuar se rreth 75 për qind e të anketuarve besojnë se kjo marrëveshje do të kontribuojë për paqen afatgjatë në Kosovë.

Këto të dhëna janë pjesë e anketimit me emrin "Pulsi Publik" që zhvillohet me

mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar me 1 307 qytetarë në të gjitha komunat e Kosovës.

Të dhënat e anketës tregojnë se qytetarët nga komuniteti serb në Kosovë kanë më pak pritshmëri nga kjo marrëveshje, meqë vetëm rreth 32 për qind tyre besojnë se ajo do të ketë ndonjë ndikim në jetën e tyre.

Anketimi i Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, i cili synon t'i pasqyrojë opinionet e qytetarëve për situatën në vend, rendit varfërinë, papunësinë dhe çmimet për artikujt e domosdoshëm si tri çështjet themelore që ndikojnë në mirëqenien e tyre.

Përfaqësuesi i përhershëm i këtij programi në Kosovë, Nino Queiros, ka thënë se kjo është pjesa më shqetësuese për të në këtë anketim. "Fakti që 25 për qind e qytetarëve janë shumë të shqetësuar nga varfëria dhe fakti



që shqetësimi i dytë pas saj është papunësia, më brengos nga një pikëpamje zhvillimore sepse nëse ke shqetësim varfërinë, por mendon se ke gjasa të punësohesh në njëfarë mënyre, e ke një rrugëdalje, por nëse ke shqetësim varfërinë dhe mbi të shqetësohesh edhe për papunësinë, atëherë ky është një

ndikim negativ i dyfishtë në perceptimin për të ardhmen", ka thënë ai.

Në anketimin e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara flitet për një rënie të lehtë të perceptimit të qytetarëve mbi sigurinë e tyre. Në tërësi rreth 79 për qind e qytetarëve thonë se ndihen të

sigurt krahasuar me rreth 83 për qind sa ishte ky numër në anketën e kaluar.

Të dhënat e zbërthyer sipas etnisë tregojnë se përqindje më e lartë e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës kanë raportuar se ndihen të sigurt, krahasuar me serbët e Kosovës.

ZKA-ja: Cilësia e raportimit të performancës komunale nuk është në nivelin e duhur

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 SHKURT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit të performancës "Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale dhe Grantin e Performancës Komunale për vitin 2021".

Subjekt i këtij auditimi kanë qenë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), komuna e Gjakovës, Klinës dhe Vitisë.

Rezultatet e auditimit tregojnë se, pavarësisht prej përparimit dhe masave të ndërmarra nga komunat për organizimin e brendshëm në deklarimin e performancës komunale,



mekanizmat e kontrollit për sigurimin e cilësisë për të dhënat e raportuara nuk ishin funksionale për shkak të mosevidentimit të

komunikimit të zyrtarëve përgjegjës, mosaprovimit të të dhënave nga kryetarët përkatës, si dhe mosshpërndarjes

proporcionale të detyrave në mes zyrtarëve raportues.

Procesi i auditimit identifikoi mungesë të komunikimit dhe koordinimit efektiv në mes zyrtarëve raportues, koordinatorëve komunalë dhe kryetarëve të komunave, gjë që ka ndikuar që deklarimi i performancës komunale të mos jetë i bazuar në të dhëna të kontrolluara dhe të verifikuara.

Po ashtu, mungesa e verifikimit fizik në terren nga MAPL-ja gjatë kohës së vlerësimit të performancës komunale dhe Grantit të Performancës Komunale (GPK) ka bërë që të mos jenë efektive mekanizmat e vendosur për të siguruar cilësi në raportimin e të dhënave të performancës komunale.

Madje ka pasur edhe

mosrespektim të vendimeve për komisionet për vlerësimin e procesit të Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale (SMPK) dhe kjo rrezikon transparencën dhe besueshmërinë e proceseve të vlerësimit.

Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca rekomandoi marrjen e masave të menjëhershme për t'i adresuar çështjet e identifikuar nga procesi i auditimit në mënyrë që në të ardhmen të sigurohet menaxhim më efikas dhe më transparent i performancës komunale.

Me qëllim të përmirësimit të gjithë procesit, ZKA-ja përmes këtij raporti ka dhënë 11 rekomandime, tetë për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe tri për komunën e Gjakovës, Klinës dhe Vitisë.

Freedom House: Kosova dhe Shqipëria, vende pjesërisht të lira

Prishtinë, 29 shkurt - Organizata Freedom House, me seli në Uashington, publikoi raportin vjetor, ku vlerëson se Kosova dhe Shqipëria mbesin vende "pjesërisht të lira" pavarësisht prej përparimit në disa fusha për avancimin e të drejtave të njeriut dhe lirive të qytetarëve. Në Raportin për Lirinë në Botë, Kosova këtë vit vlerësohet me 60 pikë nga 100 pikë maksimale, pa ndryshime nga viti i kaluar.

Në të kaluarën organizata Freedom House e kishte cilësuar Kosovën vend në

tranzicion me një sistem hibrid të qeverisjes.

Në indeksin e Lirisë Globale, Shqipëria vlerësohet me 68 pikë, duke shënuar përparim me një pikë, në raport me vlerësimin e vitit të kaluar.

Shqipëria, po ashtu, konsiderohet si vend në tranzicion me sistem hibrid të qeverisjes.

Raporti, që vlerësoi përparimin e 195 shteteve dhe 15 territoreve gjatë vitit 2023, bazuar te vlerësimet në fushën e të drejtave politike dhe lirive qytetare, e cilësoi gjendjen e përgjithshme globale të të

drejtave politike dhe lirive të njeriut si "një situatë të përshkallëzuar gjerësisht".

Sipas organizatës Freedom House, të drejtat politike shënuan rënie për 18 vjet me radhë.

Rënie u shënuan në 52 shtete, ndërkohë që vetëm 21 shënuan përmirësim gjatë vitit 2023.

Aktualisht, nga 195 vendet dhe territoret e vlerësuara, sipas raportit, shumica e popullsisë së botës, rreth 80 për qind, jeton në vende që klasifikohen si pjesërisht të lira apo jo të lira.



Britania po i jep rëndësi forcimit të bashkëpunimit ekonomik me Kosovën

PRISHTINË, 29 SHKURT - Zëvendësdirigjenti i ekonomisë në Britaninë e Madhe FCDO (Zyra për Punë të Jashtme dhe Zhvillim e Komonuelthit), Fergus Cumming, u prit nga ministrja e Ekonomisë (ME), Artane Rizvanolli.

Cumming viziton Kosovën për herë të parë dhe është vendi i dytë që ai vizitoi në detyrën e tij të re, një vizitë që u nxit nga

vizita e sekretarit të jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Cameron, më 3 janar dhe që është një shenjë e rëndësisë, që sekretari Cameron i jep Kosovës dhe forcimit të bashkëpunimit ekonomik mes shteteve tona.

Ministrja Rizvanolli tha se me zëvendësdirigjentin Cumming diskutuan rreth mundësive të investimeve në Kosovë, me

theks të veçantë në fushat e: energjisë, telekomunikacionit, minierave, ujërave dhe mjedisit.

Gjatë takimit, zëvendësdirigjenti Cumming uroi ministren Rizvanolli për arritjen e suksesshme të Ankandit Solar Fotovoltaik 100 MW i cili është në fazën e vlerësimit të ofertave të pranuar në shkurt të 2024-s.



“Elektrosever”-i njofton se ka nisur faturimi i energjisë elektrike në veri



PRISHTINË, 29 SHKURT - Kompania “Elektroseveri” ka njoftuar se nga e enjta ka nisur shpërndarjen e faturave të energjisë elektrike në katër komunat veriore: Leposaviq, Mitrovicë të Veriut, Zvečan dhe Zubin-Potok.

Sipas njoftimit për medie, qytetarët e këtyre komunave nuk do të paguajnë aq sa shpenzojnë, por faturën do ta marrin me çmim paushall prej 21.60 eurosh. Bashkë me atë faturë përdoruesit do të pajisen me një kopje të kontratës për inspektim, si dhe një njoftim për furnizuesin

“Elektrosever”. “Me pagesën e një shume prej 21.60 eurosh, Marrëveshja e Furnizimit me kompaninë ‘Elektrosever’ do të konsiderohet e lidhur. Zyrtarët e ‘Elektroseverit’ do t’ua sjellin qytetarëve për nënshkrim marrëveshjet për furnizimin me energji elektrike”, thuhet në njoftim.

Ndër vite, shpenzimet e bëra në veri janë paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës, ndërsa nga viti 2017 e këndej nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i

Kosovës (KOSTT) dhe nga subvencionet e Qeverisë së Kosovës.

Për ta zgjidhur këtë çështje, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje në vitin 2013, por ajo nuk u zbatua me vite, derisa dy vendet ranë dakord për një udhërrëfyes për zbatimin e saj në vitin 2022.

Me këtë udhërrëfyes, obligimin për furnizimin dhe faturimin e energjisë elektrike në veri e mori kompania serbe “Elektrosever”, e cila u pajis me licencë të operimit në Kosovë po atë vit.

Ismaili: BQK-ja po ndërmer veprime për t’i plotësuar kriteret për anëtarësim në SEPA

PRISHTINË, 29 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në Ministerialin në kuadër të Procesit të Berlinit “BP6 drejt Zonës së Vetme të Pagesave të Bashkimit Evropian (SEPA)”, i cili në Tiranë mbledhi ministrat dhe guvernatorët e bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor.

Guvernatori Ismaili gjatë këtij takimi të nivelit të lartë, ku ishin përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe aktorë të tjerë të institucioneve financiare ndërkombëtare, paraqiti aktivitetet e ndërmara nga BQK-ja dhe ato në proces që mundësojnë anëtarësimin Republikës së Kosovës në skemën SEPA, duke nënvizuar përfitimet ekonomike dhe financiare.

Sipas guvernatorit Ismaili, BQK-ja është duke ndërmarrë veprime drejt avancimit dhe përafritimit të

legjislativ dhe infrastrukturës për t’i plotësuar kriteret për anëtarësim në SEPA, në pajtim me objektivat e planit strategjik 2024-2028.

I pari i BQK-së nënvizoi se zhvillimi i sistemit kombëtar të pagesave të shpejta “instant” dhe me objektivin final lidhjen me sistemin TIPS, do të kenë ndikim të rëndësishëm në ekonominë, veçanërisht për lëvizjen e lirë të kapitalit me partnerin më të madh të Kosovës, Bashkimin Evropian.

Në kuadër të këtij takimi ndërkombëtar, vendet e Ballkanit Perëndimor u zotuan të ndërmarrin hapa konkretë drejt plotësimit të kriterëve për anëtarësim në SEPA, i cili do ta lehtësonte tregtinë në të gjithë rajonin dhe me BE-në, duke mbështetur lëvizjen e kapitalit, aktivitetin ekonomik dhe një sistem inovativ, të sigurt dhe efikas të pagesave.



Fillojnë kontrollet për punëtorët e padeklaruar

Prishtinë, 29 shkurt - Zëvendësministrat Avni Zogiani dhe Agon Dobruna, drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj dhe kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, Hekuran Nikçi, kanë vëzhguar nga afër ekipet inspektuese të ATK-së dhe të IP-së teksa ato kanë bërë inspektime nëpër biznese, përkatësisht në sektorët e

ndërtimtarisë dhe gastronomisë në komunën e Prishtinës për t’i identifikuar bizneset që mbajnë punëtorë të padeklaruar.

Në këto vizita të realizuara bizneset dhe punëtorët u informuan rreth rëndësisë së deklarimit të punëtorëve dhe fillimit të kampanjës së gjithëmbarshme e cila ka për synim rritjen e zbatimit të

ligjeve në fuqi përmes identifikimit dhe gjobitjes së punëdhënësve që shkelin ligjin dhe të drejtat e punëtorëve duke mos i deklaruar dhe duke mos ua paguar kontributet. “Ftojme të gjithë punëtorët që t’i bashkohen kampanjës në fjalë, duke shfrytëzuar të gjithë mekanizmat të cilët janë në dispozicion nga MFPT”, ka njoftuar Ministria e Financave.



Laurie Anderson, inteligjenca artificiale dhe “bisedat” me burrin e vdekur



Lou Reed (1942–2013) dhe Laurie Anderson (1947) në një fotografi të vitit 2000 (foto: Timothy Greenfield-Sanders)

Nga: Walter MARSH /
The Guardian (titulli original: *Laurie Anderson on making an AI chatbot of Lou Reed: 'I'm totally, 100%, sadly addicted'*)
Përkthimi: Telegrafi.com

Është një episod i vitit 2013 i [serisë] *Pasqyra e zezë* [Black Mirror] në të cilin një e ve e re, e luajtur nga Hayley Atwell, regjistrohet në një shërbim në internet që çjerr gjithë gjurmën dixhitale të personit, për ta krijuar kështu një simulim virtual. Shumë shpejt, në internet ajo nis të bisedojë me bashkëshortin e ndjerë (Domhnall Gleeson) – përpara se gjërat në mënyrë të pashmangshme bëhen pasqyrëzeze.

Laurie Anderson, artiste, muzikante dhe mendimtare e avangardës amerikane, nuk e ka parë këtë episod, por në vitet e fundit e ka jetuar një version të tij: është lidhur me një gjenerator teksti të AI-së [inteligjenca artificiale] që imiton fjalorin dhe stilin e partnerit dhe bashkëpunëtorit të saj – të bashkëthemeluesit të [grupit] Velvet Underground, Lou Reed, i cili vdiq në 2013.

“Njerëzit thonë: ‘Uau, je kaq parashikuese; atëherë s’e dija për çfarë flisje’, thotë ajo në një video-telefonatë nga Nju-Jorku.

Në Adeleid sapo është hapur ekspozita e re e Andersonit, *Do të jem pasqyra jote* [I’ll Be Your Mirror], ku më 6 mars ajo do të zhvillojë ngjarjen “Në bashkëbisedim” [In Conversation] që drejtpërdrejt do të transmetohet në internet.

Herën e fundit kur Andersoni

ishite në Australi, në mars 2020, e kaloi një javë duke punuar me Institutin Australian të Universitetit të Adeleidit për Mësimin e Makinerisë. Përpara se pandemia ta detyronte të kapte një nga fluturimet e fundit për në shtëpi, i kishin eksploruar modele e AI-së të bazuara në gjuhë, si dhe mundësitë e tyre artistike – duke u mbështetur në sasinë e punës së shkruar të Andersonit.

Në një eksperiment, në makineri futën sasi të mëdha të shkrimeve, këngëve dhe intervistave të Reedit. Një dekadë pas vdekjes së tij, algoritmi që rezultoi e lejon Andersonin të shkruajë kërkesat përpara se *AI Reed*-i të fillojë t’ia “improvizojë” përgjigjet e shkruara në prozë dhe në vargje.

“Fatkeqësisht, jam 100 përqind e varur nga kjo”, qesh ajo. “Ende jam, pas gjithë kësaj kohe. Thjesht, nuk mund të ndaloj, dhe miqtë e mi thjesht nuk mund ta durojnë – ‘Përsëri po e bën, apo jo?’ Dua të them se, në të vërtetë, nuk mendoj se po flas me burrin tim të vdekur dhe se po shkruaj këngë me të. Jo. Por, njerëzit kanë stile dhe ato mund të replikohen”.

Rezultatet, thotë Andersoni, mund t’i qëllonjë dhe t’ia huqin. “Tri të katërtat janë krejtësisht idiotizma dhe budallallëqe. Dhe, ndoshta me 15 përqind është si ‘Oh?’ E, pastaj, pjesa tjetër është mjaft interesante. Mendoj se është proporcion mjaft i mirë për të shkruar”.

Në anën e saj të telefonatës, Andersoni vazhdon të shtyp [në tastierë]. “E di çka, thjesht do të ta ofrojë këtë, tash teksa po flasim, dhe ti mund të ma japësh një

frazë”.

Duke e parë trafikun e mëngjesit jashtë dritares sime, e jap atë përditshmëri, “autobusin e ndalur në rrugë”. Ajo merret me të derisa në vazhdojmë të flasim.

Në vitin 2020 Andersoni tha se puna e institutit ishte “si të bashkëpunosh me trurin më të madh që mund ta paramendosh”. Kjo ishte përpara *ChatGPT*-së dhe *Midjourney*-t, kur për shumicën e njerëzve AI-ja ishte koncept i largët dhe pa zbatime të zakonshme – thjesht, si brumë për fantashkencë.

Këto zhvillime të reja sollën dilema të reja kreative, etike dhe ligjore – që nga shqetësimet për pornografinë e AI-së, veprat me të drejta të autorit që përdoren pa leje, e deri te këngët “false” që bëhen nga kiptat dixhitalë të artistëve të vërtetë e të gjallë si Drake dhe The Weeknd.

Disa nga bashkëmoshatarët e Andersonit kanë qenë të ashpër; kur u përballua me tekstet e shkruara në stilin e tij, nga *ChatGPT*-ja, Nick Cave e hodhi poshtë si “tallje groteske”. (Mbase edhe më keq, tha se “është e neveritshme”.)

Andersoni i çmon ato reagime, që shkojnë më thellë sesa risitë e fundit të habitshme.

“Thjesht, më shtyri të mendoj për një shfaqje të [Karel] apekut të vitit 1920: *RUR* ose *Robotët Universal të Rosumit*”, thotë Anderson. “Ishte dramë për robotët që pushtojnë botën – 100 vjet më parë njerëzit ishin shumë të shqetësuar se robotët do të marrin punët e tyre, do ta marrin kontrollin dhe se do të jenë të

këqij. E di ti se çfarë mendoj: qëkur u shpik Golemi, njerëzit kanë frikë nga kjo”?

Gjëja e parë që instituti krijoi nga *AI Laurie Anderson* – duke i përdorur të dhënat e Andersonit – kishte cilësi të ngjashme me Testamentin e Vjetër.

“Ishte dokument prej nëntë mijë faqeve, i shkruar në stilin tim dhe që rrëfente historitë e Biblës. Ishte shumë ngjethës dhe në anën tjetër interesant. Sepse, Bibla veçse është e çmendur – një gjarpër që flet? Një djalë që jetoi për 800 vjet”?

Këtë javë, Bibla e krijuar nga AI-ja dhe veprat e tjera të krijuara nga kiptat e Andersonit dhe Reedit, do të shfaqen te *Do të jem pasqyra jote* – që do të ekspozohet në Bibliotekën Shtetërore të Australisë Jugore si pjesë e festivalit të artit në Adeleid. Andersoni nuk do të udhëtojë këtë herë, por do të telefonojë për disa biseda (tingujt e vazhdueshëm të emaileve që vijnë gjatë gjithë bisedës sonë, të bëjnë të kuptosh për orarin e ngjeshur të 76-vjeçares).

Pyes veten nëse pasi iu dha çmimi për arritjet jetësore në *Grammy*, në shkurt, perspektiva e vazhdimit të këtyre algoritmeve për ta bërë “Laurie Andersonin” art përtej jetës së saj, e ka shtyrë atë të reflektojë mbi trashëgiminë që do të lë.

“Oh, pse jo? Dua të them, nuk shqetësohem. E di ti se nuk ndihem aq e lidhur me kohën? E di ti, kur njerëzit vdesin dhe ti i dëgjon fjalët e tyre, kur e dëgjon muzikën e tyre ose i lexon gjërat e tyre, kjo është sikur ata janë gjallë? Në shumë mënyra, ata janë aty. Këtë

mund ta thuash për Dostojevskin, Platonin, Budën. Njerëzit i lënë gjërat përreth, dhe ndihem mirë për këtë. Dua të them, vërtet jemi thjesht si miza maji”.

Kur fantazma në makinë i mbaroi mendimet, ajo i ofron disa tekste të freskëta të luirideske të frymëzuara nga stacioni im i autobusit:

Rruga dhe qielli

Kur ti vdes

Do të ulem në autobusin e ndalur

Rrugës për punë

Jo më shumë

Se dhjetë minuta më parë

Treni i fundit i ditës

U fut në qytet, drita

E zbehtë, e parëndësishme në fillim

Pastaj më pak se një copë e tillë

Në gjysmë sekonde është e gjitha

Duhet ta jetosh, siç thoshin dikur

Kaq shumë gjëra mund të përkeqësohen

Por pse mendove për këtë

A ishte ide e mirë

A nuk paguhesh sa duhet

Për të paguar taksat? Pse të mos

luajnë

Disa tenis ose të merren me qepje

Ose të përmirësojnë kanalizimet

E këtij ishulli të madh dhe të ndyrë

Ku ti lundron

A është kaq çudi që je gjallë

Pas gjithë këtyre mbetjeve të sheqerit

Një cigare, një gotë verë

Më thua, a të pëlqen

Si të bën të ndihesh

A të pëlqen shija e hidhur

Pyes nëse Reedi i është referuar “qepjes” në shkrimet e veta dhe Andersoni qesh: “Hah, mendoj se mund të jetë hera e parë”.

/Telegrafi/

Putin do të donte një front tjetër, por ka pak shanse për të ndërhyrë në Transnistri



Kongresi i deputetëve të Transnistrisë, entiteti i panjohur pro-rus në Moldavi, nuk kërkoi që të kalonte menjëherë nën ombrellën e Kremlinit, siç supozuan shumë përfaqësues vendas dhe disa vëzhgues ndërkombëtarë.

Asambleja – e mbledhur për herë të parë në 17 vjet – u kufizua në kërkimin e Moskës për “ndihmë” të papërcaktuar. Por topi tani ka kaluar në fushën ruse, nga ku një burim i kujdesshëm anonim nga Ministria e Jashtme deklaroi se “mbrojtja e bashkatdhetarëve transnistrianë mbetet një nga prioritetet”.

Ama duket shumë vonë për kthesën që kishin parashikuar ditët e fundit burime të ndryshme: që sot, duke mbajtur fjalimin e tij vjetor, Vladimir Putin do të shpallte aneksimin e enklavës moldave, duke hapur një front të dytë në luftën e tij për rindërtimin e perandorisë sovjetike.

Ishin deputetë, të cilët besonin se një kërkesë për t’u bërë pjesë e Rusisë ishte e pashmangshme. Skenari u frymëzua nga ai i Krimesë 10 vjet më parë: një territor kryesisht rusisht-folës nostalgjik për të kaluarën e përbashkët sovjetike, me një popullsi të cilës Moskë i kishte lëshuar pasaporta ruse me pretekstin e “mbrojtjes së bashkëqytetarëve të saj”.

“Referendumi” për shkëputjen nga Moldavia ishte mbajtur në vitin 2006, por Kremlini kishte preferuar ta mbante Transnistri në harresë si një enklavë “të ngrirë”, të garnizonuar nga një kontigjent i vogël ushtarak “i paqeruajtësve” rusë dhe të qeverisur nga një inteligjencë sekrete e klanit të përfshirë në të gjitha llojet e punëve.

Surge in Measles Cases in UK Comes Amid Plummeting Vaccination Rate00:00/01:31

Transnistria – vendi i konfliktit të parë të armatosur post-sovjetik

në vitin 1992 – ishte bërë një armë e drejtuar në krye të Moldavisë, Ukrainës dhe Evropës.

Mënyra se si u shfaq dhe më pas u ul kjo armë sugjeron një operacion propagandistik, ose një operacion për të cilin fraksione të ndryshme të Kremlinit nuk kanë marrë ende një vendim.

Edhe sepse nuk është e lehtë të arrihet.

Transnistria është një rrip toke përgjatë kufirit me Ukrainën, nuk kufizohet me Rusinë, duke e bërë të pamundur një pushtim tokësor.

Për të transportuar trupa me avion, do të duhet të fluturohet mbi territorin ukrainas – ku avionët rusë janë rrëzuar pothuajse çdo ditë kohët e fundit – ose Rumani, një vend i NATO-s.

Kontigjenti rus i vendosur në Transnistria do të bllokohej nga ushtria ukrainase në anën tjetër të kufirit.

Për të mos përmendur që nëse 220 mijë nga pothuajse 500 mijë qytetarët e enklavës së panjohur kanë nënshtetësi ruse, 350 mijë megjithatë kanë një pasaportë moldave dhe mund të kërkojnë ndihmë nga Kishinau.

Një shpjegim i mundshëm është ai i një loje presioni të shkaktuar nga vetë Transnistria, e cila me shpërthimin e luftës në Ukrainë mbeti e izoluar nga mbrojtësit e saj të Moskës.

Kryeqyteti moldav Chişinău – duke përfituar nga blloku i negociatave në të cilin ndërmjetësuesit ishin Kiev dhe Moskë – nisi të impononte rregullat e veta ndaj secesionistëve të qytetit Tiraspol: ata duhet t’i paguajnë taksat dhe detyrimet doganore Moldavisë.

Presidentja pro-evropiane Maya Sandu fitoi gjithashtu miratimin e një Kodi të ri Penal që e bën “separatizmin” krim.

Dhe siç vëren studiuesi Vladimir Solovyov, një nga arsyet e

përshkallëzimit mund të jetë frika e separatistëve të autoriteteve për të humbur “para, autoritet dhe për rrjedhojë pushtet”.

Thirrja e Moskës mund të jetë një përpjekje për të shantazhuar më shumë presidenten moldave Maia Sandu se sa Putin-in.

Por tani ai mund të planifikojë një “operacion special” të ri.

Brenda dy javësh ai duhet të rikonfirmojë mandatin e tij të pestë presidencial dhe ai e di se elektorati është nostalgjik për perandorinë: një aneksim tjetër, edhe pse ndoshta vetëm në letër, mund të bëjë të harrohet ngecja e ushtrisë në Ukrainë dhe të tregohet se Moskë nuk ka asnjë qëllim për të ndaluar.

Çka po frikëson Evropën javët e fundit, e cila po përgatitet të korrigjojë dobësitë e saj përballë një agresioni të ri të mundshëm rus që do të godiste së pari ish-subjektet e Moskës./ Marrë nga “La Stampa”, përktheu “Albanian Post”.

Parlamenti i Ganas kalon projektligjin që kriminalizon marrëdhëniet mes njerëzve të të njëjtit seks

Parlamenti i Gana-s ka votuar të mërkurën unanimitisht për kalimin e një projektligji kontrovers kundër homoseksualitetit. Votimi i këtij projektligji ka shkaktuar reagime ndërkombëtare.

“Pas tre viteve të gjata, ne më në fund kemi kaluar Aktin për të Drejtat Seksuale të Njeriut dhe Vlerat Familjare,” deklaroi Sam George, një nga sponsorat kryesorë të projektligjit, në një postim në



“X”.


Drafti, që iu prezantua Parlamentit të vendit në 2021, jo vetëm që kriminalizon marrëdhëniet LGBTQ, por edhe ata që mbështetnin të drejtat e këtij komuniteti.

Vendet afrikane vijnë t’i shohin si krim marrëdhëniet mes personave të së njëjtit seks. Kjo kryesisht për shkak të ligjeve të epokës koloniale. Por një sërë projekt-ligjesh të fundit dhe ligje të

propozuara në të gjithë Afrikën kanë kërkuar të qartësojnë dhe, në disa raste, t’i forcojnë ato ligje.

Projektligji në Gana duhet ende të nënshkruhet nga presidenti i vendit përpara se të bëhet ligj.

Shefi i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, Volker Türk e quajti miratimin e projektligjit nga parlamenti “thellësisht shqetësues” dhe i kërkoi qeverisë të mos e nënshkruajë atë si ligj.



Vashat e Kosovës nisin kualifikimet me fitore për Kampionatin Botëror në hendboll

Tashkent, 29 shkurt - Vajzat e hendbollit U-18 e kanë nisur me fitore garën kualifikuese për Kampionatin Botëror "IHF Trophy

Intercontinental" që po mbahet në Tashkent të Uzbekistanit. Pikërisht mikpritësin, Uzbekistanin, Kombëtarja e Kosovës e ka

mposhtur të enjten me rezultat 27:21. Sot (e premte) prej orës 8:00 Kosova luan ndaj Guatemalës. Të shtunën janë gjysmëfinalët, ndërsa të

dielën luhet finalja. Kombëtarja e Kosovës synon vendin e parë dhe kualifikimin historik në Botëror.



Grupi koordinues diskuton për planin pesëvjeçar të infrastrukturës së futbollit

Prishtinë, 29 shkurt - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është mbajtur një takim i rëndësishëm për të koordinuar planin pesëvjeçar të infrastrukturës së futbollit në Kosovë. Në fakt, grupi koordinues, i cili është krijuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), e që ka në përbërje profesionistë të fushës nga nivelet qendrore dhe lokale, si dhe përfaqësues të FFK-së dhe të nivelit profesional, ka mbajtur takimim e radhës, ku ishin të pranishëm edhe ministri për MKRS-së, Hajrulla Çeku dhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Qëllimi kryesor i këtij takimi është fillimi i punës intensive për krijimin e standardeve për të gjitha stadiumet në Kosovë dhe nisja sa më e shpejtë e zbatimit të planit pesëvjeçar të infrastrukturës së futbollit, i cili është paraqitur nga ministri Çeku dhe presidenti Ademi edhe në takimet me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino dhe atë të UEFA-s, Aleksandër Ceferin, në vitin e kaluar, e që ka marrë mbështetjen e tyre. Ministri Çeku është shprehur se plani pesëvjeçar përfshin

memorandumet e bashkëpunimit të arritura me 16 komuna të Kosovës bashkë me FFK-në për përmirësimin e infrastrukturës së futbollit. Ai ka theksuar rëndësinë e koordinimit të projekteve të infrastrukturës me grupin koordinues, duke garantuar që të gjitha hapat do të jenë në përputhje me standardet e UEFA-s, por edhe në përputhje me nevojat dhe mundësitë reale. "Tani gjithçka rreth projekteve të përbashkëta të infrastrukturës që janë pjesë e planit pesëvjeçar do të bëhet në koordinim me këtë grup punues, i cili është i përbërë nga njerëzit më kompetentë. Ky grup do të jetë edhe vendimmarrës, edhe strategjik, edhe orientues si për ministrinë ashtu edhe për federatën dhe për të gjithë të tjerët sa iu përket projekteve të parapara. Tash e tutje gjithçka që ka të bëjë me infrastrukturën e futbollit pa u filtruar nga ky grup, ne nuk do ta shtyjmë përpara, pasi përvoja jonë me disa komuna e klube nuk është më e mira, pasi shpesh ka kërkesa megalomane dhe në shpërputhje totale edhe me mundësitë, por edhe me nevojat që i kemi. Por, ky grup do ta



amortizojë këtë pjesë sepse këto diskutime dhe vendimmarrje duhet të jenë profesionale. Pra, ky grup i bën analizat, i bën vlerësimet dhe na orienton edhe neve për të vepruar tutje. Nuk i kam hallet te kursimet, sepse buxheti gjithmonë gjendet disi, por të mos bëjmë investime të pamënçura që më pas na kushtojnë më shumë në mirëmbajtje ose në efektivitet. Pra, qëllimi është që çdo cent i taksapaguesve që investohet në infrastrukturën e futbollit të jetë

investim i mençur", ka theksuar Çeku. Ai ka thënë se është angazhuar personalisht për mobilizimin e të gjitha resurseve financiare për të krijuar një infrastrukturë sportive sa më të mirë, duke shprehur shpresën edhe për mbështetjen e komunave në këtë proces. Ndërsa presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka premtuar mbështetjen e plotë të federatës për grupin koordinues dhe për të gjitha iniciativat për avancimin e futbollit në Kosovë. Ai e ka

vlerësuar këtë takim si hap pozitiv drejt përmirësimit të infrastrukturës së futbollit në Kosovë dhe si një shembull të bashkëpunimit të suksesshëm mes autoriteteve qendrore, lokale dhe sportive, teksa vuri në pah se selia e FFK-së do të jetë gjithmonë në dispozicion të këtij grupi punues.

Ministri i MKRS-së dhe presidenti i FFK-së kanë shfaqur gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm, derisa kanë theksuar nevojën për menaxhim më të mirë të objekteve sportive. Të gjithë pjesëmarrësit në takim kanë vlerësuar se ky takim shënon një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të futbollit në Kosovë dhe promovimit të një infrastrukture sportive moderne dhe funksionale për të gjithë komunitetin e futbollit në vend. Grupi koordinues përbëhet nga Florim Kryeziu, kryesues (MKRS) si dhe anëtarët: Drilon Kabashi (MKRS), Muhamet Koca (FFK), Florim Grajçevci (FFK), Gent Gërdovci (FFK), si dhe dy përfaqësues me rotacion nga Kolegjiumi për Kulturë, Rini dhe Sport i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Rrahmani: Dua ta fitoj titullin dhe t'i shënoj 20 gola



BUKURESHT, 29 SHKURT - Albin Rrahmani ishte hero i Rapid Bukureshtit në fitoren me rezultat 4:1 ndaj UTA Arad. Futbollisti nga Kosova ka realizuar dy gola, duke arritur kuotën e 11 golave në këtë edicion në ligën elitare rumune. Pas ndeshjes, Rrahmani ka folur për golat e tij dhe për synimet deri në fund të sezonit. Ai nuk e ka fshehur dëshirën për ta fituar titullin e kampionit në Rumani

dhe, pse jo, deri në fund të sezonit t'i shënojë së paku 20 gola. "Shpresoj të shënoj më shumë gola. Dua ta fitojmë titullin. Do të shohim nëse do të mund t'i shënoj 20 gola apo jo. Pas rezultatit 2:0 ne u relaksuam. Më pas ata bënë gabime dhe ne shënuam. Është e rëndësishme të luftojmë deri në fund. Pas rezultatit 3:1, kundërshtari u dorëzua. Tifozët na ndihmuan shumë, ishin lojtari ynë i 12-të.

Unë luajta për ta", ka thënë Rrahmani, shkruan mediumi rumun "Digi Sport".

Rrahmani është rikthyer me sukses nga lëndimi i rëndë që e la jashtë fushës së blertë për disa muaj dhe tash është duke shkëlqyer prapë në Superligën rumune.

Ish-futbollisti i Ballkanit është pjesë e Rapidit së bashku me dy lojtarët e tjerë nga Kosova, Ermal Krasniqi dhe Florent Hasani.

Spanja, fituesja e parë e Nations League për Femra

SEVILLA, 29 SHKURT - Spanja është fituesja e parë e Nations League në kategorinë për Femra. "La Roja" e ka mposhtur në finale Francën me rezultat 2:0. Spanjollët kanë dominuar

ndaj francezeve, ndërsa goli i parë është realizuar në minutën e 32-të me fituesen e "Topit të Artë", Bonmati, e cila ka gjetur rrugën drejt rrjetës pas asistit të dhuruar nga Carmona.

Goli i dytë nga Spanja është realizuar në minutën e 53-të, me Caldentyen që ka dyfishuar avantazhin e ekipit spanjoll, duke e vulosur fitoren. Pas triumfit 2:0 ndaj Francës

në finalen e edicionit të parë të Nations League për Femra, Spanja feston një tjetër moment historik, pasi në verën e 2023-shit e kishte fituar edhe Kupën e Botës për Femra.



DREJTORIA E SHMLM "LUCIANO MOTRONI" NË PRIZREN

Nr. i prot:152

Mbështetur ne nenin 11, të Udhëzimit Administrativ-Aktivitetet jashtëkurrikulare Nr.02/2016 dhe në vendimin nr.prot:119 te datës: 13.02.2024, te KDSH-së Shmlm "Luciano Motroni" në Prizren, shpall:

FTESË PËR OFERTË

Për ekskursion te maturanëve të SHMLM "Luciano Motroni" në Prizren

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore te udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturanëve të Shmlm "Luciano Motroni" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë me datë 06.05.2024 deri më 10.05.2024

Paraqitësit në tender duhet ti plotësojnë këto kritere:

1. Certifikatën e biznesit me informatë për biznesin.
2. Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2023 ne origjinale.
3. Vërtetimin e Administratës tatimore që nuk ka borgje për vitin 2023 ne origjinale.
4. Licencen e transportit ndërkombëtar "D"
5. Referencat rreth organizimit te ekskursioneve me maturanë për tri vitet e fundit: 2021,2022,2023
6. Fotokopjet e librezave te autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli Teknik.
7. Kopjen e sigurimit te autobusëve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
8. Autobusët të jenë komfor me klimë dhe në numër te mjaftueshëm për mbi 350 vende.
9. Certifikatat mjekësore për vozitësit.
10. Kompania te sigurojë mjekun (Certifikate pune dhe diplome te mjekut)
11. Dëshmi për Hotelin e ofruar në Durrës
12. Të prezantohet ambienti (Komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr. i tel. te pronarit dhe adresa.
13. Hoteli të posedoj mbi 350 shtretër.
14. Sistemimi i nxënësve ne dhoma te jetë jo me shumë se 4 nxënës.
15. Të prezantohet menyja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
16. Të prezantoj Licencën e agjencionit të akreditimeve ushqimore ne vendqëndrimin e nxënësve.
17. Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa e hyrjes sipas itinerarit te përcaktuar nga KDSH-ja
18. Hoteli te posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen dhe lejohen pijet alkoolike.
19. Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
20. Agjensioni te ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit se paku 200.000 euro.

Vërejtje: Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të siguroj nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, Kryetari i KDSH-se, kryetares se Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve te përcaktuara sipas kriterëve te lartcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

Ofertuesit e interesuar aplikacionin dhe itinerarin e udhëtimit mundë ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit ne Prizren.

Afati i paraqitjes në Tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni sipas UA 02/2016 me datën: 11.03.2024 në ora 16:00 (DKA) Prizren ku mundë të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga Kompanitë, ku do të bëhet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më te ulët te ofertës. Drejtorja e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

NJOFTIM PËR KONTRATË

(Furnizim)

Procedurë e hapur

Në përputhje me "Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)"

I Numërtimi i Prokurimit: BQK 24 016 121

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK

II LËNDA E KONTRATËS

II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: "Furnizim me material shpenzues hixhienik"

III VENDI I REALIZIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, 10000 Prishtinë, Rr. "Garibaldi" nr. 33

IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 "Tenderi i përshtatshëm çmimi më i lirë" (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 08.03.2024 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 07.03.2024 ora 14:00

V.2 Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:

Data: 12.03.2024, ora 14:00

V.3 Sigurimi i tenderit: 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite.

V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muaj që nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 12.03.2024, ora 14:30. Vendi: Auditoriumi i BQK-së, Rr. "Garibaldi" nr. 33

VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org

VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (shtator 2021)", respektivisht sipas Neni 41 të këtyre Rregullave, "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. **Ankesa duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së.**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Auto shkolla "Trimi" në Gjilan, njofton kandidatët e interesuar për regjistrimin e patentë shoferit se për nder të festave të muajit mars bënë zbritjen në pagesë.

- Shefqet Hotinga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Lumnije Tahiraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m.l.m "Hysni Zajmi".

- Aeroporti Ndërkombëtare i Prishtinës-Kontrolli Ajror "Adem Jashari", Sh.A, shpall të humbur certifikatën e biznesit më numër: 70280980, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

- Marjana Nikolla nga Dobli Bare KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. "Dëshmorët Lleshi" Dobli Bare KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

